



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr. 644/2.prot

Gramsh, më 02/03/2023

Nr. 18, datë 28.02.2023
Vendim

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR NDËRTIMIN DHE OPERIMIN TË HEC-ve “KUKUR 3” DHE “KUKUR 4” NGA SHOQËRIA “KUKUR HIDRO ENERGY”shpk


Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 28.02.2023, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari I Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes së Konsumatorit, mbështetur në KPA në Republikën e Shqipërisë: në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjin nr.107/2014, datë 03.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, të ligjit nr.9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor” I ndryshuar, ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive” të ndryshuar, në VKM-në nr.591, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave e të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor” të ndryshuar (Pika 2, gërma “b”), në VKM-në nr.592, datë 09.10.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1374, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, të ndryshuar (Pika 2, gërma “b”), të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vepimtari ekonomike, si dhe prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrit Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr.01, datë 08.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I :

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor dhe kullësor publik për ndërtimin e godinës së centralit dhe veprave të marrjes për Hec-in “Kukur 3” me sipërfaqje 0.1 ha në ngastrat pyjore nr.36,38 të ekonomisë kullësore “Sojnik-Kukur”, dhe nënngastrën pyjore nr.61/b të ekonomisë pyjore “Dushku i Bulçarit” si dhe godinës së centralit e veprave të marrjes për Hec-in “Kukur 4” me sipërfaqje 0.0843 ha në ngastrën pyjore nr.21,38 të ekonomisë kullësore “Sojnik-Kukur”, dhe nën ngastrën pyjore nr.67/d të ekonomisë pyjore “Dushku i Bulçarit” nga shoqëria “KUKUR HIDRO ENERGY” shpk, Bashkia Gramsh.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes së Konsumatorit si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti I Qarkut Elbasan.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



Konc.Xh.Gjini

Konf.G.Lena

Dosja: _____

Afati i ruajtjes: _____

KRYETARI I KËSHILLIT

Greta LENA

